



**BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE**

**PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJ**

**MUAJI JANAR**



**PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS**

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet\_e\_tiranes

© **Sektori i Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social**

---

**Programi i Edukimit për Fëmijët 24-36 muaj/ Muaji JANAR**



## *Kuriozite për Muajin Janar*

- **JANARI** është muaji i parë i vitit dhe muaji i dytë i stinës së dimrit.
- Dita e parë e këtij muaji njihet si dita e Vitit të Ri dhe festohet në shumicën e vendeve në botë.
- Ky muaj nis me pushimet e Vitit të Ri dhe me festimet përkatëse.
- Në këtë muaj duhet të konsumojmë frutat dhe perimet e stinës, veçanërisht edhe frutat e thata si: arrat, lajthitë, bajamet.

## Muaji Janar– “Familja dhe profesionet”

### Grupmosha: 24 -36 muaj


| Temat Javore  | Qëllimi   | Kohëzgjatja         |
|---|---|---------------------|
| Anëtarët e familjes, fisi, marrëdhëniet midis tyre.   | Të njohim familjen dhe anëtarët e saj   | <b>Java e I-rë</b>  |
| Profesionet e anëtarëve të familjes dhe të stafit në çerdhe .   | Të njohim fëmijët me profesionet e familjarëve dhe të stafit edukator.  | <b>Java e II-të</b> |
| Profesionet e edukimit dhe të artit (mësuesja, piktori, këngëtari dhe aktori)                           | Të njohim fëmijët me profesionet e edukimit dhe artit mësues, piktor, këngëtar, aktor.                                    | <b>Java III- të</b> |
| Profesionet e shërbimit (Shitësja, parukieria, polici, zjarrfikësi, muratori, hidrauliku dhe elektrici) | Të njohim fëmijët me profesionet e shërbimit (shitësja, parukieria, polici, zjarrfikësi, muratori, hidrauliku, elektrici) | <b>Java IV-të</b>   |


- \* **Stafi edukator duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet dhe temë ditore, bashkë me fëmijët.**
- \* **Stafi i praktikon aktivitetet në bazë të zhvillimit dhe interesave të fëmijëve.**
- \* **Stafi duhet të informojë prindërit mbi temën mujore dhe javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre si dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.**



**Tema mujore: “Familja dhe profesionet”**



**Tema e javës I: Anëtarët e familjes, fisi dhe marrëdhëniet midis tyre.**



| Java I        | Rubrika   | Aktivitetet   | Mjetet e Punës  |
|---------------|---|---|---|
| <b>E Hënë</b> | <p><b>Familja Ime.</b></p>  | <p><b>Bisedë: Edukatore/ Fëmijë.</b> Edukatorja pyet: Sa anëtarë jeni në familjen tuaj? A keni motër / vëlla ? Po gjysh ose gjyshe? Edukatorja i’u shpjegon fëmijëve “Konceptin e Familjes” .</p> <p><b>Vjersha:</b> “Familja ime”.</p> <p><b>Aktivitet:</b> “Pema e Familjes”.</p> <p><b>Kënga:</b> “Familja e gishtave” .</p> | <p>Manuali i vjershave/këngëve<br/>Manuali i Lojërave<br/>Letër<br/>Degë Peme<br/>Ngjyra<br/>Ngjitës<br/>Fotografi të sjella nga prindërit</p> <p>Bashkëngjitur</p> |

|                |   |   |  |
|----------------|---|---|--|
|                |   | <b>Loja:</b> Lojra të lira sipas dëshirës së fëmijëve .   | me programin gjeni:<br>Aktivitetin dhe Këngën.<br>Manuali i Lojërave   |
| <b>E Martë</b> | <p><b>Puna në familje dhe rolet në shtëpi. Roli i gjyshit / gjyshes</b></p>  | <p><b>Bisedë Edukatore-Fëmijë:</b> Edukatorja u shpjegon fëmijëve disa nga punët që mund të bëjnë anëtarët e një familjeje në shtëpi, psh. mami gatuan dhe sistemon shtëpinë, babi bën pazarin etj...</p> <p><b>Edukatoja pyet:</b> Kush gatuan në familjen tuaj?<br/>Po pazarin e ushqimeve kush e bën? Kush nga ju ka gjysh / gjyshe në shtëpi?<br/>A e dini se çfarë roli luajnë ato?</p> <p><b>Edukatoria shpjegon:</b> Rolin e gjyshërve. Gjyshërit si kujdesen për ju. Si dhurojnë dashuri për nipat dhe mbesat.<br/>Në ju sjellin në çerdhe etj...</p> <p><b>Aktivitet:</b> “Gjyshi dhe gjyshja ime”.<br/><b>Vjersha:</b> “Familja”.</p> | <p>Manuali vjershave/këngëve</p> <p>Fletë e bardhë /A4<br/>Laps<br/>Ngjyra<br/>Fletë punë dore<br/>Ngjitës / Vinovil</p> <p>Bashkëngjitur<br/>Me programin gjeni<br/>Aktivitetin / Përrallën</p> |


|                         |  |  |  |
|-------------------------|--|--|--|
|                         |  | <p><b>Kënga:</b> “E Gjyshes”.</p> <p><b>Përralla:</b> “Portreti i Gjyshes”</p>   |  |
| <p><b>E Mërkurë</b></p> | <p><b>Shtëpia ime.</b></p>  | <p><b>Bisedë: Edukatore-Fëmijë:</b> Edukatorja pyet fëmijët nëse jetojnë në shtëpi private apo në pallat ? A është e madhe shtëpia juaj? Çfarë sendesh ndodhen në dhomën tuaj? Edukatorja iu shpjegon fëmijëve kuptimin e sendeve shtëpiake.</p> <p><b>Punë dore:</b> “Shtëpia ime”.</p> <p><b>Ngjyrosje:</b> “Sende shtëpiake” (sipas modeleve të realizuara më parë nga edukatorët).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Familja”.</p> <p><b>Kënga:</b> “Familja e gishtave”.</p> <p><b>Lojra energjike me:</b> Top, karrige , shami etj..</p> | <p>Manuali vjershave.</p> <p>Bashkëngjitur me programin gjeni këngën. Fletë punë dore. Ngjitës.</p> <p>Modele për ngjyrosje.</p>  <p>Manuali i Lojërave.</p> |
| <p><b>E Enjte</b></p>   | <p><b>Argëtim me familjen.</b></p>   | <p><b>Bisedë Edukatore-Fëmijë:</b> Edukatorja pyet: A keni shkuar me prindërit në kënde lojrash? Cila lodër ju pëlqen më shumë? Po me shokët dhe shoqet i ndani lodrat?</p>  | <p>Manuali i vjershave/ këngëve.</p>   |

|                        |   |  |   |
|------------------------|---|--|---|
|                        |  | <p><b>Punë Dore: Me plastelinë:</b> Fëmijët krijojnë lodrën e preferuar .</p> <p><b>Aktivitet: Improvizimi i një pikniku.</b><br/>Edukatorja pyet fëmijët se çfarë dëshirojnë ata të marrin me vete në piknik. Edukatorja orienton fëmijët për të marrë sendet, ushqimet, lodrat e preferuara.</p> <p><b>Kënga:</b> “Familja e Gishtave”.</p> <p><b>Kënga :</b> “E gjyshes”.</p> <p><b>Përralla:</b> “Pikniku i Arushit Tedi”.</p> | <p>Mjete: Plastelina</p>  <p>Bashkëngjitur me programin Gjeni Këngën.<br/>Libri :<br/>Përralla e caktuar</p> |
| <p><b>E Premte</b></p> | <p><b>Përsëritja e aktiviteteve të javës</b></p>                                  | <p><b>Përsëritje:</b> E bisedave, vjershave të mësuara gjatë javës.</p> <p><b>Ekspozitë:</b> Me punimet e fëmijëve të realizuara gjatë kësaj jave.</p> <p><b>Kënga :</b> “Familja e Gishtave”.</p> <p><b>Përralla:</b> “Portreti i Gjyshes” .</p>  | <p>Manuali vjershave/këngëve.</p> <p>Bashkëngjitur me programin gjeni Këngën dhe Përrallën</p>  |
|                        |   |  |   |



**Tema mujore: “Familja dhe profesionet”**





**Tema e javës II: Profesionet e familjes dhe profesionet e stafit në çerdhe.**




| Java II              | Rubrika  | Aktivitetet  | Mjetet e Punës   |
|----------------------|--|--|--|
| <p><b>E Hënë</b></p> | <p><b>Njohja me profesionin e prindërve</b></p>  | <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja pyet fëmijët: Çfarë pune bën mami? Çfarë pune bën babi?</p> <p>Sipas dëshirës mund të jetë prezent një prind (mami ose babi) që të prezantojnë profesionin e tyre tek fëmijët .</p> <p><b>Vjersha:</b> “Kur shkon mami për në punë”.</p> <p><b>Kënga:</b> “Vesh me kominoshe”.</p> <p><b>Lojë imituese:</b> “Profesioni i mamit ose babit”.</p> <p>Përdorim uniformën dhe mjetet e punës sipas profesioneve</p> | <p>Manuali i vjershave/këngëve</p> <p>Manuali i lojërave</p> |



|                  |  |  |   |
|------------------|--|--|---|
|                  |  | që do të përmenden gjatë bisedës me edukatoren.  |   |
| <b>E Martë</b>   | <b>Njohja me profesionin e Edukatores</b><br> | <b>Loja imituese:</b> “Bëj sikur”. Profesionin e edukatores.<br><b>Vjersha</b> e edukatores.<br><b>Krijimtari:</b> Përgatitja e kartolinës për “Edukatoren”.<br><b>Lojë :</b> Lojëra energjike me top, karrige, etj....  | Manuali i vjershave/këngëve<br>Manuali i lojërave .<br>Fletë me ngjyra<br>Gërshërë<br>Ngjitës<br> |
| <b>E Mërkurë</b> | <b>Njohja me profesionin e kuzhinieres.</b>  | <b>Vizitë:</b> “Në kuzhinë”. Teta kuzhinierja iu shpjegon çfarë ushqimesh ka përgatitur për atë ditë.<br><b>Aktivitet: Improvizim:</b><br><b>Përgatitja e kekut:</b> Me ndihmën e edukatoreve/kuzhinieres fëmijët marrin enët dhe materialet e nevojshme si: vezë, | Manuali i Vjershave/këngëve<br>Manuali i lojërave   |



|                       |   |  |   |
|-----------------------|---|--|---|
|                       |    | <p>miell, maja, kos, sheqer, që nevojiten për përgatitjen e brumit të kekut. Pas përgatitjes,brumin e vendosin në një tavë dhe e pjekin në furrë. Ky është keku më i shijshëm, pasi është bërë nga duart e vockla të vogëlushëve tanë.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Babi im”</p> <p><b>Përrallë:</b> “Byreku i mbretit”</p>   |  <p>Përralla e caktuar .</p>   |
| <p><b>E Enjte</b></p> | <p><b>Njohja me Profesionin e mjekut</b></p>  | <p><b>Bisedë:</b> Edukatorja pyet: A jeni vizituar ndonjëherë tek mjekja? Kur vizitohemi tek mjeku?</p> <p><b>Vizitë tek mjekte/mjeku:</b> Edukatorët mund të ftojnë një mjek ose mjekte për t’iu shpjeguar fëmijëve profesionin e tyre .</p> <p><b>Vjersha:</b> “Mikrobet”.</p> <p><b>Kënga:</b> “5 Majmunët e vegjël”.</p> <p><b>Loja imituese:</b> Bëj sikur “Profesioni mjekes”.</p> | <p>Manuali i vjershave/këngëve Ngjyra (Modele të përgatitura më parë nga edukatorët ). Bashkëngjitur me programin gjeni Këngën.</p>  |


|                 |   |   |   |
|-----------------|---|---|---|
|                 |   | <b>Vizatim/Ngjyrosje:</b> Mjetet e punës së mjekut.   |   |
| <b>E Premte</b> | <p><b>Parada e profesioneve</b></p>  | <p><b>Ekspozitë:</b> Me punimet e fëmijëve.</p> <p><b>Aktivitet:</b> “<b>Parada e Profesioneve</b>”. Edukatorja orienton fëmijët të vishen më uniformat e profesioneve të realizuara gjatë javës dhe të përgatisin me to një paradë në grup.</p> <p><b>Loja:</b> Lojra energjike me top, litar, karrige etj..</p> <p><b>Përrallë e lirë:</b> Sipas librave që disponojne në grup.</p> | <p>Manuali i lojërave.<br/>Libra me përralla.</p> |



**Tema mujore: “Familja dhe profesionet”**

**Tema e javës III: Profesionet e edukimit dhe të arteve mësues, piktor, këngëtar, aktor.**



| Java III             | Rubrika  | Aktivitetet   | Mjetet e Punës  |
|----------------------|--|---|---|
| <p><b>E Hënë</b></p> | <p><b>Njohja me profesionin e mësuesit</b></p>  | <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-Fëmijë. Edukatorja i’u shpjegon fëmijëve profesionin e mësueses.<br/>Atë ditë edukatorët mund të ftojnë një mësues /mesuese, të cilët i’u shpjegojnë fëmijëve rreth profesionit të tyre në shkollë dhe rolin që kanë në edukimin e fëmijëve.</p> <p><b>Loja imituese:</b> “Bëj sikur” (profesioni i mësueses)<br/>Udhëheq edukatorja e grupit.</p> <p><b>Aktivitet:</b> “<b>Punë Dore</b>”: Mjetet shkollore: (Lapsa, vizore, gërshërë, libra, ngjitës etj.)</p> <p><b>Realizimi i aktivitetit:</b> Me ndihmën e edukatores fëmijët vizatojnë me laps mjetet shkollore si laps, vizore, ngjitës etj. Më pas edukatorja pret me gërshërë vizatimet e përfutuara dhe ndihmon fëmijët që t’i ngjisin mjetet shkollore në një tabelë.</p> | <p>Manuali i Lojrave .</p> <p>Fletë me ngjyra .</p> <p>Laps</p> <p>Gërshërë</p> <p>Ngjitës</p>  |

|                  |   |   |   |
|------------------|---|---|---|
|                  |   | <b>Përrallë e lirë:</b> (sipas librave që disponojnë në grup)   | Libra me përralla.  |
| <b>E Martë</b>   | <b>Njohja me profesionin e piktorit.</b><br> | <b>Bisedë:</b> Edukatore–Fëmijë: Edukatorja i’u shpjegon fëmijëve profesionin e piktorit. Fëmijët së bashku me edukatoren identifikojnë mjetet e punës së piktorit (penel, telajo, bojra etj. )<br><br><b>Loja:</b> “Unë jam piktor”<br><br><b>Përralla:</b> “Furça dhe Peneli” | Bashkëngjitur me programin gjeni Lojën dhe Përrallën Çërçaf i bardhë Letër A4 lapsa me ngjyra / bojra uji . |
| <b>E Mërkurë</b> | <b>Njohja me profesionin e këngëtarit</b>   | <b>Bisedë:</b> Edukatorja pyet: A ju pëlqen të dëgjoni muzikë dhe të këndonit? Si quhen ndryshe njerëzit që këndojnë? Këngëtar/e. Edukatorja shpjegon profesionin e këngëtarit.<br><br><b>Loja imituese :</b> “Bëj sikur”, “Profesioni i këngëtarit”                            | Manuali i lojrave/ këngëve .<br><br>Ngjyrosje figura e këngëtarit. (Model i përgatitur nga edukatorja)      |



|                       |   |   |  |
|-----------------------|---|---|--|
| <p><b>E Enjte</b></p> |  <p><b>Njohja me profesionin e aktorit.</b></p>  | <p>Fëmijët interpretojnë një këngë të preferuar, të cilën e kanë mësuar më parë duke luajtur rolin e këngëtarit.</p> <p><b>Ngjyrosje:</b> Fëmijët ngjyrosin figurën e këngëtarit.</p> <p><b>Këngë:</b> “Lëvizore”</p> <p><b>Loja:</b> Lojra energjike me top, karrige, litar, birrila etj ...</p> <p><b>Filmi vizatimor:</b> “Arushi kërkon Babanë”.<br/>Edukatorja i’u shpjegon fabulën dhe profesionet e përmendura në film .</p> <p><b>Punë me dorë:</b> “Kllouni”: Me ndihmën e edukatores fëmijët mësojnë dhe presin me gërshtëri forma gjeometrike të vizatuara më parë nga edukatorja dhe i ngjisin si sy rrethorë, hundë drejtkëndësh, kapelë trekëndësh ose rrethore për ndërtimin e maskës së kllounit.</p> | <p>Fletë punë dore me ngjyra.<br/>Laps<br/>Gërshtëri<br/>Ngjitës</p> |
|-----------------------|---|---|--|

|                        |   |   |   |
|------------------------|---|---|---|
| <p><b>E Premte</b></p> | <p><b>Përsëritja e aktiviteteve të javës.</b></p> | <p><b>Bisedë:</b> Përsëritje e temave, vjershave këngëve të mësuara gjatë javës.</p> <p><b>Ekspozitë:</b> Me punimet e fëmijëve.</p> <p><b>Loja:</b> Lojra energjike me top, karrige, litar, birrila.</p> | <p>Manuali i vjershave/këngëve .</p> <p>Manuali i lojërave.</p> |
|------------------------|---|---|---|





**Tema mujore: “Familja dhe profesionet”**


**Tema e javës IV: “Profesionet e shërbimit: Shitësja, parukierja, zjarrfikësi, polici, hidrauliku, elektrikisti, muratori”**






| Java IV       | Rubrika   | Aktivitetet   | Mjetet e Punës   |
|---------------|---|---|--|
| <b>E Hënë</b> | <p><b>Njohja me profesionin e shitësit/es.</b></p>  | <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë: Edukatorja i’u shpjegon fëmijëve profesionin e shitëses/it. Të cilët u shërbejnë njerëzve. Edukatorja pyet fëmijët: Ku e keni parë ju vetë shitësi/en?</p> <p><b>Lojë imituese:</b> “Dyqani i kukullave”.</p> <p>Edukatorja i orieton fëmijët të ndahen në role shitës – blerës.</p> <p><b>Ngjyrosje:</b> “Profesioni i shitëses” .</p> <p><b>Lojra:</b> Lojëra energjike me top, birrila, litar.</p> | <p>Manuali i lojërave<br/>Ngjyrosje:<br/>Model i përgatitur nga edukatorja.</p>  |



|                         |  |  |  |
|-------------------------|--|--|--|
| <p><b>E Martë</b></p>   | <p><b>Njohja me profesionin e parukieres.</b></p>   | <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon profesionin e parukieres, e cila i shërben njerëzve për t'i zbukuruar. Edukatorja mund të ftojë një parukiere atë ditë, e cila i'u prezanton fëmijëve profesionin e saj.</p> <p><b>Lojë imituese:</b> Bëj sikur “ Profesioni parukieres”.</p> <p><b>Punë dore:</b> Me fletë punëdore realizohen me ngjitje mjetet e punës se parukieres.</p> <p><b>Përrallë e lire:</b> Sipas librave që disponon në grup.</p>    | <p>Fletë punëdore me ngjyra<br/>Gërshërë<br/>Ngjitës</p>  <p>Libra me përralla.</p>   |
| <p><b>E Mërkurë</b></p> | <p><b>Njohja me profesioin zjarrfikësit.</b></p>  | <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë: Edukatorja i'u shpjegon profesionin e zjarrfikësit. Ajo pyet fëmijët: “A keni parë ndonjëherë zjarrfikëse? Çfarë bën zjarrfikësi?”</p> <p>Atë ditë mund të jetë prezent dhe një zjarrfikës për t'iu shpjeguar fëmijëve profesionin aq të rrezikshëm dhe aq të dobishëm që bën të mundur shuarjen e flakëve, shpëtimin e njerëzve.</p> <p><b>Loja imituese:</b> “Bëj sikur” (profesioni i zjarrfikësit). Udhëheq edukatorja e grupit.</p> | <p>Manuali i Lojërave<br/>Fletë punëdore me ngjyra .<br/>Gërshërë<br/>Ngjitës.</p>  |

|                       |  |  |                                      |
|-----------------------|--|--|--------------------------------------|
| <p><b>E Enjte</b></p> | <p><b>Njohja me profesionin e policit.</b></p>  | <p><b>Punëdore:</b> “Makina zjarrfikëses”.</p> <p><b>Lojë:</b> Lojëra energjike me top, kërcim/vallëzim, etj.</p> <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatoria pyet: Ku i keni parë policët? Çfarë bëjnë ata? Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve që policët ndihmojnë njerëzit të luftojnë keqbërësit, ndihmojnë trafikun dhe njerëzit të kalojnë në vijat e bardha, ndihmojnë fëmijët kur ata mund të humbasin nga prindërit ose kur fëmijët ndjehen keq prej të rriturve keqbërës.</p> <p><b>Loja imituese :</b> “Bëj sikur”, “Profesioni i Policit”.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Semafori”.</p> | <p>Manuali i vjershave/këngëve .</p> |
|-----------------------|--|--|--------------------------------------|

|                        |  |  |   |
|------------------------|--|--|---|
| <p><b>E premtë</b></p> | <p><b>Njohja me profesionin e elektrikistit, hidraulikut dhe muratorit .</b></p>   | <p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë : Edukatorja iu shpjegon fëmijëve profesionin e elektrikistit, hidraulikut dhe muratorit. Ajo pyet: Kush kujdeset që të kemi gjithmonë drita në shtëpi? Po për ujin? E keni parë ndonjëherë hidraulikun ose elektrikistin? Po muratorin?</p> <p><b>Loja me kuba:</b> Ndërtimi me kuba i një pallati / shtëpie.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Babi im është murator”.</p> <p><b>Ngjyrosje :</b> Uniforma e elektrikistit, muratorit dhe hidraulikut.</p> | <p>Manuali i Vjershave/këngëve.</p> <p>Manuali i lojërave</p>  <p>Modele.<br/>Lapsa me ngjyra.</p> |
|------------------------|--|--|---|